

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Pse po flet Mirel Mërtiri i inceneratorëve?
ADRESA	https://www.cna.al/aktualitet/pse-po-flet-mirel-mertiri-i-incenatoreve-i475453
BURIMI	cna.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	29 shtator 2026, 08:29:12 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	29 shtator 2026, 08:08:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	74022ea7c6a4118f6c71080957d939789c80fd711556341cf1c9242333b8bfd1
TEKSTI	feb4de42c48d5f033b03d9281e50a4a76a8fa1a9a7ddbc47334dfa7b664b0036
PAMJA	a7e19095a40ebd9268556c5b94eae0122b061548a4963108f7b0f81efc422acb

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	97eb7c53b65a3d0011287f7eea521f88c24e84b192474b62725f258cc788315c
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	00c036a8b9d029228ae2ceb40f7ad3139dd1ddd4285277109f3fa37fa73abd7e
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

https://scan.stamles.eu/verify/97eb7c53b65a3d0011287f7eea521f88c24e84b192474b62725f258cc788315c

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [AKTUALITET](#)
- [POLITIKË](#)
- [KRONIKA](#)
- [EKONOMI](#)
- [SOCIALE](#)
- [DENONCIM](#)
- [STIL](#)
- [SPORT](#)
- [TECH](#)
- [KULTURE](#)
- [BLOG](#)
- [LIVESTREAM](#)



English
English

Pse po flet Mirel Mërtiri i inceneratorëve?



29 Shtator 2026, 10:08, Aktualitet CNA



Pas 3 vitesh në arrati, mendja kryesore e aferës së inceneratorëve, Mirel Mërtiri, pritet të shfaqet në një dokumentar, të regjisorit dhe producentit Frederik Fussel, që do të transmetohet në një televizion austriak.

Sipas një postimi të bërë nga gazetaria Lindita Çela, shfaqet një video ku ai jep një USB dhe menjëherë thashethemet kanë pushtuar kryeqytetin.

Pjesë nga transkripti i dokumentarit:

Gazetari: Pra, çfarë ka në këtë USB?

Dëshmitari: Të gjitha të dhënat, të gjitha pagesat...

Gazetari: Pra, nëpërmjet kësaj USB-je mund të shkosh te të gjitha...? **Dëshmitari:** Të gjithë njerëzit që unë po akuzoj sot.

Gazetari: Pra, këtu ke emrat?

Dëshmitari: Ke emra, shumën e parave, ke të dhëna, ke dhe arsyet se pse janë paguar këto para tek ata...





Skandal i ri në Shqipëri?/ Regjisor i austriak me USB "bombë", politikanë dhe skema korrupsioni

Çfarë ka thënë Mirel Mërtiri? Kush janë personat që janë paguar? Nga kanë kaluar këto para? Cilët janë ndërmjetësit? A ka fatura? Për çfarë është përdorur Mirel Mërtiri?

Shumë pikëpyetje, por edhe shumë thashetheme. Dikush thotë që pagesat shkojnë në nivele më të larta të njerëz të afërt të kryeministrit, janë paguar para për njerëzit afër Erion Veliajt, për mediat, një pjesë e tyre, kjo e fundit publikuar nga CNA.

CNA është media e parë që ka raportuar pagesa zyrtare të bëra për mediat nga kompanitë e inceneratorëve si dhe gjithashtu kemi zbuluar skemat e kalimit të pagesave në disa studio ligjore në emër të Stela Gugalles apo Klodian Zotos.



Ekskluzive - Pagesat e inceneratorëve për mediat/ Dalin email-et e Zotos dhe Gugalles

Mirel Mërtiri ndodhet në arrati. Ai u shfaq në "Syri TV" dy vite më parë në një emision, ku i pyetur nga gazetari Çim Peka, Mërtiri nuk tha asgjë. U përpoq në atë kohë të ishte mjaft i ftohtë.

Pse, lind pyetja? Sepse ndoshta Mirel Mërtiri shpresonte se do të kishte mbështetjen e qeverisë dhe kryeministrit Edi Rama për ta zgjidhur problemin që kishte me drejtësinë. Në fakt, nuk ndodhi ashtu.



Çim Peka dështon "live" me Mirel Mërtirin/ "Shpërthen" gazetari: S'të kam thirrur për sytë e bukur

Halli i Mirel Mërtirit me drejtësinë shkoi në SPAK, u hetua dhe ai është një nga personat që akuzohet si pjesë e një grupi të strukturuar kriminal për aferën e landfillit të Sharrës.

Nga ana tjetër, Mirel Mërtiri shkoi në Austri së bashku me Stela Gugallen, bashkëjetuesen dhe nënën e fëmijëve të tij. ***Sipas të dhënave nga vetë Mirel Mërtiri, por dhe të konfirmuara zyrtarisht nga CNA, njeriu kryesor i inceneratorëve e ka humbur betejën ligjore në Austri. Pra, Mërtiri po flet, pasi pritet të ekstradohet në Shqipëri.***



Afera me inceneratorët/ SPAK-u ia komunikon akuzat avokatit të Mirel Mërtirit

Të njëjtat burime saktësuan se ai ka humbur gjyqet në të gjitha shkallët e drejtësisë austriake dhe duhet të ekstradohet. Duke parë këtë situatë dhe problematikën që mund të lindë me ekstradimin e tij dhe bashkëshortes edhe për shkak të fëmijëve, Mirel Mërtiri tashmë ka vendosur të krijojë një skemë të re.

Të dalë të bëjë një dokumentar, ndoshta për të kërkuar "pazarin" e radhës për të mos u ekstraduar nga Austria. Në fakt, Mërtiri është në dy kohë. Herën e parë kur doli në "Syri TV" dhe nuk tha asgjë dhe tani që pretendon se ka nxjerrë një USB.


Ky duket si një shantazh ndaj qeverisë dhe drejtësisë. Një skemë e radhës për të shpëtuar lëkurën. Mirel Mërtiri po flet se çfarë do ai vetë të thotë, jo se çfarë është e vërteta dhe se çfarë duan të dinë shqiptarët.



A po bëhet i penduari i drejtësisë Mirel Mërtiri?

Në fakt, Mirel Mërtiri duhet të flasë dhe të thotë të vërtetat që di me fakte dhe dokumente, se cila ishte skema që i dha kompanisë së tij fantazmë ende të pakrijuar 8% pikë bonus. Si bashkëpunoi me Bashkinë e Tiranës dhe deri ku shkon afera e dherave? Sa % e të ardhurave ishin premtuar për zyrtarët e lartë? Cilat ishin mediat e korruptuara dhe të përfshira në aferën e inceneratorëve? Si është përdorur ai për blerjen e mediave? Cilët kanë qenë bashkëpunëtorët më të ngushtë? Cilat kanë qenë lidhjet me kryetarin e Bashkisë së Tiranës, ministra, zyrtarë dhe deri te kryeministri?

Këto janë pyetjet të cilave duhet t'u japë përgjigje Mirel Mërtiri përtej disa shpërthimeve të kontrolluara në mediat e huaja, të cilat kërkon t'i përdorë për të shpëtuar lëkurën e tij. /CNA





Të sugjeruara

Ja ku pritet të nisë sezoni i ri i "Të Paekspozuarit" nga Ylli Rakipi

Nga heqja e akcizës të nafta të rialokimi i fondeve/ Blegtorët i drejtohet qeverisë me 7 kërkesa

Dita e emrit të Kryepiskopit Joan/ Fortlumturia e Tij merr urime dhe vlerësime nga Primatët e lartë të Kishave

Ndalimi i importeve të mishit nga Brazili/ Përpunuesit paralajmërojnë rritje të çmimeve deri në 40%

KLSH zbulon parregullsi të rënda/ Krizë financiare te "Trajtimi i Studentëve" në Korçë

"O shok i Agasit"/ Fundo ia numëron socialistit: 13 vite në pushtet, e njëjta narrative

Gazetari: Mazhoranca ka sulmuar drejtësinë e re për rastin e Veliajt, ka "masakruar" prokurorin Dadon

"Media e ka denoncuar"/ Gazetari: Rama asnjë reagim për inceneratorët, nuk mban përgjegjësi morale

"Në radhë për një takim me Agasin"/ Elvi Fundo zbulon "bëmat" e kabinetit të Ramës

Fundo i "përvishet" Klosit: Shtetit i vunë "zjarrin", mazhoranca e Agasit

Gazetari "plas bombën": Ergys Agasi ishte në fushatën e PS-së në Durrës

Mbi 4 muaj protestë/ Qytetarët vijojnë thirrjet për dorëheqjen e Ramës

Shfaqet për herë të parë në publik/ Kush është kreu i komanduar i SHISH-it, Elvis Lila

AKSK paralajmëron qytetarët: Kujdes me llogaritë në Whatsapp, mund të humbni aksesin

Zjarr i madh në Memëlisht, rrezikohet zona pyjore

Garda pengoi gazetaren të raportonte/ Reagon AGSH: Mohim i aksesit për të ushtruar detyrën

Zgjerimi i BE-së/ Ndërkombëtarët: Shqipëria ka ndërmarrë hapa pozitivë

Anëtarësimi në BE/ Rama: Shqipëria përparësi ndaj vendeve të tjera

Burimas, protesta për ujin/ Banorët kundër projektit për furnizimin e Zvezdës


Skandali / Drejtuesit e SHISH vodhën targat e SPAK-ut, ja kush lëvizte me mjetin

[editorial](#)

09:11 Editorial Bujar Leskaj

Të ndihmojmë SHISH-in të mbrojë shtetin nga krimi, dhe jo krimin nga shteti!!

CNA LIVESTREAM





Na ndiqni edhe në



[acromax](#)

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.